



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
**OSNOVNI SUD DJAKOVICA – BASIC COURT OF GJAKOVË**

---

**AD/GJTHGJA. nr. 07/24**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË** – kryetari i gjykatës Nikollë Komani, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga ankuesi F. Th. nga Prizreni, ndaj gjyqtarit D. H., pas shikimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të ankesës, me datën 26 dhjetor 2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**Refuzohet** ankesa disiplinore e parashtruar nga ankuesi F. Th. nga Prizreni, ndaj gjyqtarit D. H., si e pabazuar.

**A r s y e t i m**

Me datën 12 dhjetor 2024 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, konform nenit 9 par.1 pika 1.1 lidhur me par. 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcjellë te autoriteti kompetent ankesën disiplinore të parashtruar nga ankuesi F. Th., nga Prizren, ndaj gjyqtarit D. H..

Pas pranimit të kësaj ankese dhe pas analizimit të përmbajtjes së saj, e njëjta është regjistruar në librin e ankesave disiplinore me numër AD/GJTHGJA.nr. 07/24 me datën 12 dhjetor 2024 dhe janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore që janë në kompetencë të kryetarit të Gjykatës, sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë.

Me shkresën AD/GJTHGJA.nr. 07/2024 të datës 12 dhjetor 2024, përmes email-it zyrtar është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës, për veprimet e ndërmarra lidhur me ankesën e parashtruar nga ana e ankuesit.

Ankuesi, F. Th. nga Prizreni, zyrtar policor me gradën Toger, me pozitë Udhëheqës në Njësinë për Hetimin e Narkotikeve në Prizren/DHTN, ka paraqitur ankesë kundër gjyqtarit D. H. për mosrespektim të afatit për paraqitje të provave. Ka theksuar se prokurorja e çështjes ka sekuestruar kundërligjshëm telefonat mobil duke përfshirë në këtë rast telefonin tij personal “Samsung Galaxy

A72” dhe kartelat e numrave mobil +38344... dhe +38349..., duke e autorizuar IPK-në të kryej veprim të tillë pa marr aktvendim për fillim të hetimeve dhe pa urdhër të gjykatës. Aktvendimin për fillim të hetimeve prokurorja e ka marr me datën 03.05.2024, katër ditë pasi janë sekuestruar telefonat mobil. Me datë 08.05.2024 prokurorja ka bërë kërkesë Gjykatës Themelore në Gjakovë, për lëshimin e urdhrin ndalues përfundimtar dhe në kërkesë prokurorja fare nuk përmend këshillën juridike se në afat prej 15 ditëve sipas nenit 263 të KPRK-së, ne kemi të drejtë të paraqitjes së provave kundër kërkesës së saj. Me datë 14.05.2024 përmes avokatit të autorizuar B. M., në Gjykatën Themelore në Gjakovë me shkrim kam paraqitur pretendimet dhe provat lidhur me kërkesën për lëshimin e urdhrin ndalues përfundimtar dhe gjyqtari i procedurës paraprake D. H., nuk e respekton afatin prej 15 ditëve për paraqitjen e provave nga ana e jonë në cilësinë e të pandehurit siç parashihet me nenin 263 të KPRK-së, të drejtat e të pandehurit dhe palës së tretë para nxjerrjes së urdhrin ndalues përfundimtar, mirëpo pas dy ditëve nga kërkesa e prokurores me datë 10.05.2024 lëshon urdhrin ndalues përfundimtar për sekuestrim të telefonave mobil. Ndaj urdhrin përfundimtar të gjyqtarit avokati B. M., ka paraqitur ankesë për në Gjykatën e Apelit dhe Kolegjin Shqyrtues në Gjykatën Themelore në Gjakovë dhe të njëjtat i kemi dorëzuar brenda afatit ligjor. Gjyqtari në këshillën juridike të urdhrin ndalues përfundimtar kishte shënuar se kemi të drejtë ankesë në afat prej 15 dite në Kolegjin Shqyrtues në Gjakovë dhe jo në Gjykatën e Apelit, edhe pse në këto raste Gjykata e Apelit duhet të shqyrtoj ankesat. Gjykata në Gjakovë e ka njoftuar me email Gjykatën e Apelit lidhur me ankesat ndaj urdhrin ndalues përfundimtar, mirëpo dokumentet e bashkangjitura në email kanë qenë të pa vulosura nga gjyqtari D. H.. Gjithashtu ankesat nuk janë dorëzuar fizikisht në Gjykatën e Apelit fare e të cilën procedurë është dashur ta zbatoj Gjykata Themelore në Gjakovë në mënyrë që gjykata e Apelit të procedoj me shqyrtimin e ankesave. Me datë 26.08.2024 prokurorja merr aktvendim për pushimin e hetimeve në këtë çështje pasi ishte kryer ekzaminimi i telefonave mobil dhe nuk ishin gjetur informacione dhe prova të cilat prokurorja kishte pretenduar. Me datë 03.09.2024 gjyqtari paraprak D. H. revokon urdhëresën për urdhër ndalues përfundimtar dhe vendos ti kthej telefonat mobil tek të gjithë zyrtaret policor DHTN-Njësia në Prizren.

Vonesat në dërgimin e ankesave tona për shqyrtim në Gjykatën e Apelit dhe revokimi i urdhrin ndalues përfundimtar nga gjyqtari D. H. ka pamundësuar shqyrtimin e ankesave tona në Gjykatën e Apelit lidhur me ligjshmërinë e sekuestrimit të telefonave mobil. Urdhri ndalues i përkohshëm nuk është lëshuar nga prokurorja por e njëjta ka bërë kërkesë në Gjykatën Themelore në Gjakovë për lëshimin e një urdhri të tillë, pasi ne nuk kemi pranuar një urdhër ndalues të përkohshëm dhe dyshojmë se ai urdhër nuk është lëshuar fare nga gjykata dhe prokuroria. Lëshimi i urdhrin ndalues përfundimtar nga gjyqtari D. H. për neve është marr në kundërshtim me dispozitat ligjore, prandaj edhe kemi paraqitur ankesë në gjykatën e apelit. Ne dyshojmë se mos dërgimi i ankesave tona në Gjykatën e Apelit dhe pastaj revokimi i urdhrin ndalues përfundimtar nga gjyqtari paraprak ka qenë i qëllimshëm për të mbuluar shkeljet ligjore që prokurorja dhe gjyqtari kanë bërë gjatë trajtimit të kësaj çështje. Gjithashtu, pretendoj se sekuestrimi i telefonit tim mobil për më shumë se 4 muaj, ekzaminimi dhe qasje në të dhënat e mija private dhe telefonike ka qenë e kundërligjshme nga ana e prokurores dhe gjyqtarit të çështjes, sepse është pamundësuar shqyrtimi i ankesave tona në Gjykatën e Apelit për arsyet e lartcekura. Andaj, shpresoj që titulli i lartshënuar do ta shqyrtoj më kompetencë ankesën e gjyqtarit D. H. për shkeljet që unë pretendoj që i ka bërë si gjyqtar paraprak në lëndën PPr.Kr.nr.2024:129715.

Gjyqtari D. H., në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e ankuesit ndër të tjera ka theksuar se: unë në bazë të kompetencave kushtetuese kam vepruar si gjyqtar i departamentit përkatës lidhur më çështjen paraprake, ku me datën 03.05.2024 kam pranuar shkresat e lëndës në çështjen penale paraprake, ndaj parashtresit të ankesës F. Th. etj. Pas marrjes së shkresave të lëndës, prokurori i shtetit kishte filluar hetimin me aktvendimin PP/I.nr. 20/24 me datën 03.05.2024 ndaj të pandehurit njëherit paraqitësit të ankesës dhe të tjerëve, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoriteti zyrtar nga neni 414 par.1 të KPRK-së dhe për vepra të tjera. Me datën 08.05.2024 nga prokurori i çështjes është paraqitur kërkesa për urdhrin ndalues përfundimtar ku i është bashkangjitur urdhri për ndalim të përkohshëm i datës 03.05.2024 (obligim ligjor është i prokurorit të shtetit që ti njoftoj palët lidhur me kërkesën për urdhër ndalues përfundimtar). Gjyqtari i procedurës paraprake me urdhëresën PPr.Kr.nr. 2024:129715 të datës 10.05.2024, ka lëshuar urdhrin ndalues përfundimtar ndaj të pandehurve në fjalë, duke i dhënë këshillën juridike që palët e pakënaqura në afat prej 15 ditëve të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit, si dhe i ka njoftuar palët më këtë urdhëresë, ku nga ana e palëve në procedurë janë ushtruar ankesat, ankuesi i kësaj parashtrese, ankesën e ka dorëzuar me datë 28.05.2024. Gjyqtari i procedurës paraprake me 03.06.2024 ka përcjell çështjen në Gjykatën e Apelit për vendosje lidhur me ankesat e lartcekura, e këtë e dëshmon sistemi i SMIL-it dhe akt përcjellësi (lënda paraprake nuk dërgohet në mënyrë fizike por nëpërmjet sistemit SMIL, ku e tërë lënda është skanuar). Me datë 10.06.2024 prokuroria ka parashtuar kërkesë për urdhër ndalues përfundimtar ku i është bashkëngjitur urdhri ndalues i përkohshëm edhe ndaj një të pandehuri tjetër, e ku nga ana e gjykatës është lëshuar urdhëresa PPr.Kr.nr. 2024:129715 e datës 10.07.2024 për urdhër ndalues përfundimtar. Me datë 28.08.2024 prokurori i çështjes ka marr aktvendim për pushim të hetimeve ndaj të pandehurve që kanë qenë subjekt i hetimeve dhe ka paraqitur kërkesë për kthimin e sendeve të sekuestruara (lënda ende e pa trajtuar në Gjykatën e Apelit sipas ankesave lidhur me urdhrin ndalues përfundimtar). Gjykata–gjyqtari i procedurës paraprake me urdhëresën PPr.Kr.nr. 2024:129715 të datës 30.09.2024, ka lëshuar urdhëresë duke e revokuar urdhrin ndalues përfundimtar të datës 10.05.2024 dhe 10.07.2024, ndaj të pandehurve në fjalë dhe duke ia kthyer të gjitha sendet e konfiskuar (lënda ende e pa trajtuar në Gjykatën e Apelit sipas ankesave për urdhrin ndalues përfundimtar). Nga prokurori i çështjes me datë 26.08.2024 është bërë pushimi i hetimeve dhe kërkesa për kthimin e sendeve të konfiskuara, mirëpo si gjyqtari i çështjes nga data 19.08.2024 deri me 30.08.2024 kam qenë në pushim vjetor dhe nuk kam pasur si të bëjë kthimin e sendeve, pasi në punë kam dal me 02.09.2024, ndërsa me datë 03.09.2024 kam lëshuar urdhëresën për kthimin e sendeve. Me datë 20.09.2024 është paraqitur kërkesa nga avokati B. M. duke theksuar se me datë 28.05.2024 kam paraqitur ankesë ndaj urdhrin ndalues përfundimtar, e po ashtu sipas informatave ka qenë edhe pala ankuese ku është njoftuar se lënda është në Gjykatën e Apelit dhe nuk është vendosur ende. Pala ankuese apo edhe të tjerët nga administratori i Gjykatës së Apelit janë njoftuar se kinse gjykata e shkallës së parë nuk e ka përcjell lëndën, duke ardhur palët në Gjykatën Themelore në Gjakovë dhe duke shprehur pakënaqësitë, ku edhe nga vet kryetari jam pyetur, e të njëjtën e kam njoftuar se nga data 03.06.2024 lënda është me ankesë në Gjykatën e Apelit për vendosje. Po ashtu, pas kësaj gjykata e shkallës së dytë ka kërkuar që lënda ti dërgohet fizikisht edhe pse e njëjta ka qenë e dërguar sipas sistemit të SMIL-it (siç është e përcaktuar nga KGJK se lëndët paraprake me ankesë dërgohen sipas sistemit të SMIL-it) ku vet personalisht i kam dërguar email zyrtar kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe i kam njoftuar lidhur me veprimet e administratorit të Gjykatës së Apelit. Ka theksuar se vlen të ceket se edhe sot me rastin e përpilimit të kësaj deklaratë, lënda gjendet në Gjykatën e Apelit nga data e 03.06.2024, andaj ankesën e parashtuar nga F. Th. e konsideroj si të pabazuar për faktin se unë

kam vendosur si gjyqtari i procedurës paraprake dhe nga ana ime nuk ka pasur vonesa, ndërsa lidhur më pretendimet ankimore për vendimmarrje është kompetencë ta shqyrtoj gjykata e shkallës së dytë, ashtu që veprimet e mija nuk përbejnë shkelje disiplinore e as prolongim të procedurës.

Kryetari i Gjykatës, pas vlerësimit dhe analizimit të ankesës së ankuesit, deklaratës së gjyqtarit, si dhe shkresave të lëndës PPr.Kr.nr. 2024:129715, gjeti se **ankesa është e pabazuar**.

Kryetari i Gjykatës, ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e ankuesit për shkeljet e pretenduara që janë bërë nga ana e prokurores së Prokurorisë Themelore në Gjakove dhe ka konstatuar se si kryetar i gjykatës nuk ka kompetencë për të vlerësuar veprimet e prokurorisë në këtë procedurë, pasi që kompetent është kryeprokurori i Prokurorisë Themelore, ndërsa nga kryetari i Gjykatës janë shqyrtuar pretendimet e ankuesit që kanë të bëjë me gjyqtarin.

Meqenëse lënda fizike ndodhet në Gjykatën e Apelit sipas ankesave të ushtruara, shkresat e kësaj lëndë janë nxjerrë nga programi i SMIL-it. Nga analiza e shkresave të lëndës është konstatuar se kërkesa për urdhër ndalues përfundimtar është bërë më 08.05.2024. Gjyqtari i procedurës paraprake, ndaj të cilit është parashtruar ankesa, ka lëshuar urdhër ndalues përfundimtar më 10.05.2024, kundër të cilit të gjithë të pandehurit, përfshirë ankuesin F. Th., kanë paraqitur ankesa. Ankesa e F. Th. është dorëzuar më 28.05.2024. Pas pranimi të ankesave, gjyqtari i procedurës paraprake, më 03.06.2024, ka përcjellë lëndën përmes programit SMIL në Gjykatën e Apelit, dhe jo përmes email-it, siç ka deklaruar ankuesi. Gjithashtu, sipas programit SMIL, të gjitha ankesat e palëve dhe urdhri i gjykatës janë ngarkuar me nënshkrim dhe vulë, pasi që paraprakisht të gjitha shkresat janë skanuar dhe ngarkuar, siç është vepruar edhe në këtë rast.

Nga shkresat e lëndës është konstatuar se, pasi gjyqtari i procedurës paraprake ka aprovuar kërkesën e prokurorisë dhe ka lëshuar urdhrin ndalues përfundimtar, i njëjti urdhër ju është përcjellë të gjitha palëve, ku secila ka paraqitur ankesë. Ndërsa pretendimet e ankuesit se mos dërgimi fizik i shkresave të tij në Gjykatën e Apelit ka qenë i qëllimshëm për të fshehur shkeljet ligjore që prokurorja dhe gjyqtari kanë bërë gjatë trajtimit të kësaj çështje, janë vlerësuar dhe analizuar nga kryetari i Gjykatës. Nga vlerësimi dhe analiza u konstatua se ky pretendim nuk qëndron, për shkak se, bazuar në të dhënat e programit SMIL, është konstatuar se të gjitha shkresat janë dorëzuar në mënyrë elektronike në Gjykatën e Apelit, dhe kjo mund të vërtetohet saktësisht nga ky program, në të cilin janë të evidentuara të gjitha shkresat e lëndës. Skanimi dhe regjistrimi i shkresave të lëndës dhe dërgimi i tyre në Gjykatën e Apelit gjatë procedurës paraprake janë paraparë edhe me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nr. 424/2021, të datës 29 dhjetor 2021. Në nenin 1 të këtij vendimi përcaktohet: *“Aprovohet forma elektronike për procedimin e ankesave në lëmin penale gjatë procedurës paraprake në mes të gjykatave themelore dhe Gjykatës së Apelit përmes Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) dhe procedimin e ankesave përmes SMIL-it në Gjykatën e Apelit”*. Duke u bazuar në këtë vendim, gjyqtari i procedurës paraprake, kundër të cilit është paraqitur ankesa, ka dërguar lëndën në Gjykatën e Apelit përmes programit SMIL, pasi kjo lëndë është pjesë e procedurës paraprake, siç parashikohet

në këtë vendim. Andaj, mbi këto baza dhe konstatime, nuk ka pasur shkelje ligjore në veprimet e gjyqtarit që do të përbënin shkelje disiplinore, ashtu siç pretendon ankuesi.

Po ashtu, janë vlerësuar dhe analizuar pretendimet e ankuesit se mos dërgimi i ankesave për shqyrtim në Gjykatën e Apelit dhe pastaj revokimi i urdhrit ndalues përfundimtar nga gjyqtari ka qenë i qëllimshëm për të fshehur shkeljet që prokurorja dhe gjyqtari kanë bërë gjatë trajtimit të kësaj çështje. Këto pretendime janë shqyrtuar nga kryetari i Gjykatës dhe bazuar në shkresat e lëndës, është konstatuar se një pretendim i tillë i ankuesit është i pabazuar dhe nuk ka mbështetje në dispozita ligjore. Gjyqtari ka vepruar brenda kuadrit të procedurës paraprake, dhe në këtë fazë të procedurës gjykata është e lidhur me kërkesat e prokurorisë, pasi që me aktvendimin PP/I.nr.20/2024, të datës 26.08.2024, prokuroria ka pushuar hetimet e filluara me aktvendimin PP/I.nr.20/2024, të datës 03.05.2024, dhe kjo është kompetencë ligjore e prokurorisë. Pas pushimit të hetimeve nga ana e prokurorisë më 26.08.2024, është parashtruar kërkesa për kthimin e sendeve, dhe gjyqtari, duke vepruar në përputhje me këtë kërkesë, ka lëshuar urdhëresën PPr.Kr.nr. 2024:129715, me të cilën ka revokuar urdhrin ndalues përfundimtar dhe ka kthyer sendet e konfiskuara për të gjithë, duke përfshirë edhe ankuesin.

Kryetari i gjykatës ka vlerësuar dhe analizuar pretendimin e ankuesit se vonesat në dërgimin e ankesave dhe revokimi i urdhrit ndalues përfundimtar nga gjyqtari ka pamundësuar shqyrtimin e ankesave lidhur me ligjshmërinë e sekuestrimit të telefonave mobil dhe bazuar në shkresat e lëndës dhe deklaratën e gjyqtarit është konstatuar se në mënyrë elektronike përmes programit të SMIL-it lënda është dërguar menjëherë pas ankesave, pastaj sipas kërkesës së Gjykatës së Apelit është dërguar edhe dosja fizike, e lënda gjendet në Gjykatën e Apelit ku do të shqyrtohen të gjitha ankesat e parashtruara dhe do të vendoset lidhur me ligjshmërinë dhe bazën ligjore të vendosjes nga gjyqtari i procedurës paraprake me rastin e lëshimit të urdhrit ndalues përfundimtar, ashtu që gjyqtari me asnjë veprim nuk ka penguar shqyrtimin e ankesave nga Gjykata e Apelit, siç pretendon ankuesi me ankesën e tij.

Andaj, mbi këto baza dhe argumente vërtetohet se në veprimet e gjyqtarit nuk janë konstatuar shkelje të ligjit, të cilat do të konsideroheshin shkelje disiplinore, për këtë arsye kryetari i Gjykatës gjeti se pretendimet ankimore janë të pabazuara, pasi nga të lartcekurat nuk rezulton se veprimet e ndërmarra nga gjyqtari D. H., përbëjnë bazë për iniciimin e procedurës disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Nga arsyet e theksuara më lartë, si dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 9 par. 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenit 7 par. 3 pika 3.2 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**AD-GJTHGJA.nr. 07/2024, datë 26 dhjetor 2024**

**Kryetari i Gjykatës**

---

**Nikollë Komani**

*Vendimi i dorëzohet:*

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Parashtruesit të ankesës*
- 3. Gjyqtarit*